



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Date/Datum.

PRISHTINË - PRIŠTINA

91/22  
19.04.22

| Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi | Data e autorizimit të ekspertit | Data e dorëzimit të raportit | Nr. i lëndës |
|--|---------------------------------|------------------------------|--------------|
| Gjemajli Bellanica;                              | 08.04.2022                      | 19.04.2022                   | 91/22        |

**BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT**

Me datën: 07.04.2022 OE N.T.P “KENI”- Podujevë, ka parashtruar ankesë me nr. 91/22 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë OE “BINI” Podujevë, lidhur me aktivitetit e prokurimit me titull: “Largimi i deponive ilegale”, me nr. të prokurimit: 615-22-378-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK –Podujevë.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar kontratë publike kornizë me një operator ekonomik, procedurë të hapur, Shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 45 000.00 €

|   |             |
|---|-------------|
| Data e njoftimit për kontratë.....                              | 28.01.2022. |
| Hapja e ofertave.....   | 21.02.2022. |
| Data e njoftimit të vendimit të AK-së.....                      | 23.03.2022. |
| Data e kërkesës për rishqyrtim.....                             | 25.03.2022. |
| Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesës për rishqyrtim..... | 30.03.2022. |

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

## DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË: OE N.T.P “KENI”- Podujevë

**Dispozitat e shkelura**

- Neni 1 – Qëllimi
- Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
- Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës
- Neni 64 - Dëshmitë e kërkesave
- Neni 66 - Përshtatshmëria Profesionale
- Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

**Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet**

Të nderuar ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK me: 23.03.2022, ku kan rekomanduar për kontrat OE N.N.T “BINI” ndërsa neve na kan shpallur si tenderues të eliminuar, me pretendimet te cilat nuk qendrojn.

Duke e favorizuat njëanshem OE N.N.T “BINI”, edhe pse shkelen dispozitat ligjore themelore te LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Ankesen tonë AK as nuk e ka marr mundimin ta lexoj dhe shqyrtoj ne mënyr të drejt,por vetem jep një përgjigjeje tekstuale, në te cilen as që e ka shiquar fare as nje pretendim tonin.

AK na shpall si tenderues te pasuksesshem me pretendimin që nuk ofrojm Referenca te mjaftueshme te puneve të ngjashme. Pretendime te cilat nuk qendrojn, sepse referencat tona e kalojn parashikimin e kerkuar ne Dosjen e Tenderit. Por shihet qartazi që favorizimi i OE-së ne fjal i ka bërë që as mos ta shfletojn dokumentacionin tonë të ofruar ne e Ofert,

Ju sqarojmë se AK na ka shpalluar te papergjegjshem per arsye te mungeses se referencave të punëve te ngjashme ne 3-vitet e fundit ne vlerë: 67,000.00 Euro , e cila nuk qëndron, sepse ne si OE kemi ofruar referenca të knaqshme të cilat e kalojn vleren e parashikuar Me liste te projekteve dhe referenca te ofruara.

*Lista e Projekteve të realizuara*

| Nr     | Titulli i Projektit                                       | Viti    | Autoriteti | Vlera        |
|--------|---|---------|------------|--------------|
| 9      | Ndërtimit fekal Repë dhe Polatë                           | 2019/20 | Podujevë   | 85,065.13 €  |
| 8      | Largimi i deponive ilegale të mbeturinave                 | 2016    | Podujevë   | 6,891.97 €   |
| 7      | Zgjerimi i shtrati të lumenjve në disa fshatra            | 2020    | Podujevë   | 9,660.76 €   |
| 6      | Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Pakashtic e eprme | 2017    | Podujevë   | 122,819.18 € |
| 5      | Rrenimi i Objektit të ish Komitetit                       | 2018    | Podujevë   | 2,815.48 €   |
| 4      | Zdherimi dhe Pastrimi i shtratit të lumenjve              | 2018    | Podujevë   | 944.00 €     |
| 3      | Zdherimi dhe Pastrimi i shtratit të lumenjve              | 2019    | Podujevë   | 16,960.38 €  |
| 2      | Mbyllja e gropave të rrezikshme në Shtedim dhe Dumnic     | 2019    | Podujevë   | 5,465.17 €   |
| 1      | Ndërtimi i kanalizimit fekal në Repë dhe Pollat           | 2019    | Podujevë   | 85,065.13 €  |
| TOTALI |   |         |            | 335,687.20 € |



Te gjitha keto jan te ofruara dhe dokumentura me Raportet Teknike dhe Referenca nga Organet Kontraktuese.

Andaj duke ju referuar argumenteve dhe fakteve te paraqitura me larte, shkeljet e dispozitave te LPP-se nga AK dhe duke pare se OE NTP KENI ka dorezuar tenderin e pergjegjshem me cmimin me te ulët kerkojm qe ankesa te aprovohet si e bazuar, lenda te kthehet ne rivleresim dhe te rckomandohemi per kontrate pasi qe jemi OE e pergjegjshem me cmimin me te ulët, duke iu referuar edhe LPP-se neni 60 paragrafi 1.1

## KRITERET PËR VLERËSIM

### Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

Regjistrimi i OE në regjistrin profesional komercial apo regjistrin e ndërmarrjeve

Certifikata e numrit fiskal

Certifikata për regjistrim në TVSh

### Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i

Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se 90,000.00 Euro

### Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, në vlerë minimale prej 67,000.00 Euro, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë). Në rast të formimit të grupit (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 60% të shumës së kërkuar në furnizime të ngjashme të realizuara në tre vitet e fundit

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon 1) një menaxher i projektit të jetë ekolog i diplomuar ose master. Të ketë së paku 2 (dy) vite përvojë pune në menaxhimin dhe implementimin e projekteve të natyrës së shërbimeve

OE duhet të ofrojë dëshmi se mund të angazhojë staf të mjaftueshëm për realizimin e këtij projekti, minimumi 15 punëtor

Mjetet e punës të domosdoshme për realizimin e punimeve në këtë projekt

- Minimumi 2 bager me minimum 20 ton
- minimumi 2 bager me minimum 14 ton
- minimumi 4 kamion për bartjen e mbeturinave

### Dëshmitë e kërkuara dokumentare të përshtatshmërisë profesionale

Certifikata e biznesit (kopje)

Certifikata e numrit fiskal (kopje)

Certifikata e TVSH (kopje)

**Dëshmitë e kërkuara dokumentare mbi gjendjen ekonomike dhe financiare**

Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një firme e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur

**Dëshmitë e kërkuara mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale**

Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të shërbimeve.

Dëshmi për menaxherin e kontratës - kopja e diplomës universitare, cv-ja, kontrata e punës, Dokumentet e përvojës së menaxherit me dëshmitë e ofruara si menaxhim të kontratave ose pranime të shërbimeve apo referencat e lëshuara për projekt menaxherin. Këto referenca duhet të mbulojnë periudhën trevjeçare të përvojës së punës së menaxherit të projektit (minimumi 1 (një) referencë për tre vitet e fundit) Nëse inxhinieri nuk është në listën e punëtorëve kërkohet marrëveshja për angazhim në këtë projekt

Lista me numër të punëtorëve e nënshkruar dhe e vulosur nga OE , kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja për angazhim në këtë projekt

Lista e pajisjeve - mjeteve të punës që OE duhet të ketë ose të kontraktuara (me qira) të dëshmohet me kopje të librezave apo ndonjë dëshmi tjetër) Në rast të marrjes me qira të dëshmohet me marrëveshje të nënshkruar dhe vulosur nga ana e dy palëve

**RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES**

*Komuna e Podujevës shpërblen me kontratë OE: "Bini" nga Podujeva në vlerë të ofertës 38,052.64 €*

**VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME**

N/A

**ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME**

N/A

## PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE N.T.P “KENI”- Podujevë

### Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

OE ankues thekson se AK-ja na ka shpallur të pa përgjegjshëm për arsye të mungesës së referencave të punëve të ngjashme në tre vitet e fundit. Kjo arsye e AK-së nuk qëndron sepse ne si OE kemi ofruar referenca të kënaqshme të cilat kalojnë vlerën e parashikuar me listë të projekteve dhe referencat e ofruar.

Eksperti shqyrtues konstaton që kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: *“Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, në vlerë minimale prej 67,000.00 Euro, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë). Në rast të formimit të grupit (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 60% të shumës së kërkuar në furnizime të ngjashme të realizuara në tre vitet e fundit”*

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: *“Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të shërbimeve”.*

Pas analizimit të dokumentacionit të ofruar në E prokurim, për këtë aktivitet të prokurimit eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues në ofertën e tij ka bashkëngjitur një listë të projekteve të realizuar, gjithashtu kësaj liste ia ka bashkëngjitur edhe dëshmitë dokumentare si raportet për pranimin e punëve, kontratë. Referencë.

Duke pas parasysh kërkesën e dosjes së tenderit që janë kërkuar dëshmitë si *“referencat ose certifikatat për kryerje të shërbimeve”*, ndërsa operatori ekonomik ankues nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme që arrin vlerën prej 67.000.00 eurove për kryerjen e shërbimeve, për faktin se AK-ja në kërkesën e saj ka kërkuar decidivisht për kryerjen e shërbimeve. Andaj pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

## MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE N.T.P “KENI”- Podujevë të refuzohet si e pa bazuara, dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Raporti i ekspertizës t’i dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues - KK - Podujevë  
Panelit Shqyrtues - OSHP  
OE ankues - OE N.T.P “KENI”- Podujevë